



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 17, datë 28.02.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË AUTORITETIT
NR. 172, DATË 21.12.2012, “MBI KRIJIMIN E FONDIT TË KOMPENSIMIT”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 45, paragrafi 4, të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, nenit 128 të Kodit të Procedurave Administrative”, me propozim të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Autoriteti me vendimin e Bordit 172, datë 21.12.2012, ka vendosur krijimin e Fondit të Kompensimit për vitin 2013, si dhe paraqitjen e vlerës së dëmeve të miratuara në masën 420,951,378 lekë, si detyrim për vitin financiar 2012.

Në vijim të korrespondencave lidhur me zbatimin e këtij vendimi, BSHS me shkresën nr. 982, prot, datë 07.02.2013, ka depozituar në Autoritet Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve nr. 06, datë 01.02.2013, duke propozuar krijimin e Fondit të Kompensimit në masën 460,000,000 lekë, të ndarë në dy vite , 2013 dhe 2014.

Propozimi i BSHS-së për krijimin e Fondit të Kompensimit për 2 vite nuk mund të pranohet, pasi në bazë të ligjit, Autoriteti vendos çdo vit shumën e kontributeve për Fondin e Kompensimit.

Gjithashtu, referuar “Informacionit mbi treguesit financiarë për periudhën **janar–31 dhjetor 2012**”, depozituar me shkresën nr. 316 prot, datë 15.01.2013, rezulton se deri më 31.12.2012, totali i dëmeve të miratuara të papaguara, është në vlerën **459,794,942 lekë**, nga të cilat vlera e dëmeve të miratuara nga komisioni i dëmeve dhe të papaguara është në vlerën **217,219,927 lekë**, ndërsa vlera e dëmeve të papaguara, (vendimeve të gjykatave të apelit, që kanë marrë formë të prerë dhe për të cilat ka filluar ekzekutimi i tyre) është në vlerën **242,575,015 lekë**.

Në këto kushte, duke qenë se kemi ndryshim të të dhënave lidhur me dëmet e miratuara dhe të papaguara, Autoriteti **vlerën prej 195,002,080 lekë** do ta konsiderojë **si rezervë mbi Fondin e Kompensimit**. Kjo vlerë është diferencë e totalit të detyrimeve të dëmeve të miratuara të papaguara në vlerën 459,794,942 lekë dhe masës së kontributit të Fondit të Kompensimit për vitin 2013, në vlerën 264,792,862 lekë.

Për sa më sipër Autoriteti,

V E N D O S I:

1. Pika 1 e Vendimit të Bordit të Autoritetit nr. 172, datë 21.12.2012, “Mbi krijimin e Fondit të Kompensimit”, të ndryshohet si më poshtë:
 1. “Shoqëritë e sigurimit të krijojnë Rezervën e Fondit të Kompensimit për vitin 2013, në vlerën 195,002,080 lekë”.
2. Pika 2 e Vendimit të Bordit të Autoritetit nr. 172, datë 21.12.2012, “Mbi krijimin e Fondit të Kompensimit”, të ndryshohet si më poshtë:
 2. “Byroja Shqiptare e Sigurimit të llogarisë Rezervën e këtij Fondi për çdo shoqëri sigurimi dhe të njoftojë shoqëritë e sigurimit për vlerat përkatëse, në përputhje me nenin 4 të Rregullores 36, datë 21.03.2012, “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve ”.
3. Pika 3 e Vendimit të Bordit të Autoritetit nr. 172, datë 21.12.2012, “Mbi krijimin e Fondit të Kompensimit”, të ndryshohet si më poshtë:
 3. “Shuma e kontributit për Fondin e Kompensimit për vitin 2013, është në masën 264,792,862 lekë”.
4. Pika 4 e Vendimit të Bordit të Autoritetit nr. 172, datë 21.12.2012, “Mbi krijimin e Fondit të Kompensimit”, të ndryshohet si më poshtë:
 4. “Fondi i Kompensimit duhet të derdhet në përputhje me parashikimet e nenit 3 paragrafi 9, i Rregullores nr. 36, datë 21.03.2010 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e fondit të kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”.
5. Pika 5 e Vendimit të Bordit të Autoritetit nr. 172, datë 21.12.2012, “Mbi krijimin e Fondit të Kompensimit”, të ndryshohet si më poshtë:
 5. “Byroja të raportojë në përputhje me nenin 8 të Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010, “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së BSHS-së, lidhur

me administrimin e këtij Fondi, me qëllim mbikëqyrjen nga Autoriteti të derdhjeve dhe të detyrimeve në zbatim të këtij Vendimi”.

6. Ngarkohet Byroja dhe Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI